



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
Kryesia

Prot 258

Tiranë, 29 mars 2022

Vendim nr. 19, datë 24 mars 2022

Për mirënjohjen Nderi i Akademisë, si dhe për kriteret dhe procedurat e dhënies së saj

Referuar nenit 10 (Çmimet e veçanta) të Rregullores për çmimet shkencore që akordohen nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë e për mënyrën e organizimit të konkurseve të tyre; nisur nga synimi për të nderuar personalitete me kontribute të shquara në kërkimin shkencor; si dhe duke vlerësuar përvojën pozitive të krijuar sipas Statutit në fuqi deri në miratimin e Ligjit 53/2019 Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë; Kryesia e Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e datës 23.03.2022,

Vendosi:

1. Të rikonfirmojë si çmim të veçantë që akordohet nga Akademia e Shkencave për vlerësimin e ngjarjeve, personaliteteve dhe zhvillimeve historiko-kulturore, në kuadër të zhvillimit të veprimtarive shkencore kombëtare e rajonale, mirënjohjen Nderi i Akademisë.
2. Mirënjohja Nderi i Akademisë jepet vetëm për studiues të suksesshëm joanëtarë të Asamblesë apo të Akademisë.
3. Nderi i Akademisë jepet për:
 - Personalitete shkencore me veprimtari të gjatë dhe të suksesshme, të vlerësuar prej bashkësisë shkencore të fushës përkatëse;

A3

- Për personalitete publike që janë shquar për mbështetjen në vijimësi të veprimtarisë së Akademisë së Shkencave për përmbushjen e misionit të saj në shoqëri.

4. *Nderi i Akademisë* jepet kryesisht në raste jubilarë, institucionale e individuale; si dhe në raste rezultatesh me ndikim të dukshëm në jetën shkencore dhe publike të vendit.

5. Propozime për dhënien e mirënjohjes *Nderi i Akademisë* bëhen nga:

- Kryesia e Akademisë së Shkencave;

- Komisionet e përhershme të kërkim-studimit dhe njësitë kërkimore që funksionojnë pranë Akademisë së Shkencave;

- Jo më pak se pesë anëtarë të Asamblesë.

Senatet e IAL-ve, kanë të drejtë t'i rekomandojnë Kryesisë së ASH propozimet e tyre.

6. Përbërja dhe funksionet e jurisë janë të njëjta si në paragrafin 4 të pikës 2 të vendimit nr. 1, datë 07.01.2022 të Kryesisë "*Për procedurat dhe kalendarin e konkursit për shpalljen e fituesit të çmimit të Karrierës për vitin 2021*". Vendimi merret me votim të hapur, mundësisht konsensual, pas njohjes me dy relacione të paraqitura nga specialistë të fushës, një prej të cilëve me titull *akademik*. Vendimi së bashku me motivacionin dhe dy relacionet i bëhet i njohur Asamblesë së Akademisë së Shkencave.

7. Mirënjohja "*Nderi i Akademisë*" përmban: diplomën, shenjën/simbolin dhe regjistrohet në një rubrikë të veçantë në *Amzën e Librit të Artë të Albanologjisë*.

8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akademik Skënder GJINUSHI

KRYETAR